



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Mars 2022

Nr: 136

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E REZULTATIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BASHKISË
LUSHNJË, QARKU FIER, NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË
DATËS 6 MARS 2022 DHE DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË
ZJ. ERISELDA MUSA SEFA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 123 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, në bashkinë Lushnjë, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie.

Në përfundim të procedurave të ankimit, në referim të përcaktimeve të nenit 2, pika 18, shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë njësi Zgjedhore.

Pasi përfundoi procesi i dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi, për Kryetarin e Bashkisë Lushnjë, nga të 2 KZAZ-të e kësaj bashkie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të nxjerrë rezultatin për këtë bashki, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123, të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 123, pika 1, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e

votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Lushnjë, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr. 54, me vendimin nr. 204, datë 7.3.2022, dhe KZAZ nr. 55, me vendimin nr. 148, datë 7.3.2022, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik dhe rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr. 54 dhe KZAZ nr. 55, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.
- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

ZAZ 55

QV me probleme	Problemi	GN	TPR	SISTEM
2872	Vota të pavlefshme	9	8	8
2872	Vota të vlefshme	187	188	188

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, qarku Fier, me shifrat e korigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, të plotësuara nga Grupi i Numërimit të Votave.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 123 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



VENDOSI:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, Qarku Fier, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të japë mandatin e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë, zj. Eriselda Musa Sefa, të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE



Për kandidatët për kryetar të bashkisë Lushnje

			Gjithsej
1	Numri Zgjedhësve që kanë votuar	gjithsej	37592
		gra	17718
2	Fletë votimi të papërdorura		67726
3	Fletë votimi të dëmtuara		43
4	Fletë Votimi të gjetura në kuti		37591
5	Vota të pavlefshme		1066
6	Vota të vlefshme		36525

Nr	Kandidatët për Kryetar		Gjithsej
1	Eriselda Musa Sefa	PS	21477
2	Indrit Shpëtim Sefa	PD	3809
3	Elton Ilir Bano	Sh-L	11238
Gjithsej vota të vlefshme			36524